Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "FutureBITS shpk" të datës 16.10.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "73Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (Digital Sender, Switch, UPS dhe kabllo UTP) – Ritender – Lot 2" me nr. të prokurimit 616-26-6675-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "FutureBITS shpk" të datës 16.10.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "73Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (Digital Sender, Switch, UPS dhe kabllo UTP) – Ritender – Lot 2" me nr. të prokurimit 616-26-6675-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "FutureBITS shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 16.10.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "73Furnizimi (blerja) e pajisjeve të teknologjisë informative (Digital Sender, Switch, UPS dhe kabllo UTP) – Ritender – Lot 2" me nr. të prokurimit 616-26-6675-1-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

*"Pretendimet ankimore kane te bejne me mospermbushjen e specifikimeve teknike per produktet numer **3,4 dhe 5** te Ankesit 1 **(UPS Rack, UPS Tower dhe Kabllo UTP)** të cilat dokumentohen duke u bazuar në Aneksin 1, në oferten teknike te operatorit të rekomanduar, broshurat e prezentuara dhe nga fletët teknike zyrtare të prodhuesve te modeleve te ofruara.*

Pretendimi 1 - UPS Rack përdorim në server rack
Mospërmbushje e autonomisë, e formatit fizik, dhe shtim i produktit dytësor për plotësim të autonomies.

Specifikimi teknik	***Kërkesa (Aneksi 1)***	***Zgjidhja e ofruar nga OE i rekomandaur***	***Pse nuk përmbushet specifikimi teknik nga modelet e ofruara***
Autonomia	*Minimum 5 minuta autonomi në 100% ngarkesë.*	*Cyberpower OLS3000ERT2UA. Fleta teknike zyrtare e prodhuesit tregon vetëm 4,2 minuta autonomi për njësinë bazë.*	*Vetë njësia UPS (2U) nuk arrin 5 minuta. Për ta kompensuar këtë, OE ka shtuar një modul të jashtëm shtesë baterie (BPSE72V40ART2U, 2U) gjë që konfirmohet nga vetë broshura dhe Oferta Teknike e OE të rekomanduar, megjithëse Aneksi 1 kërkon një UPS me bateri te veta te bredshme dhe autonomi prej 5 minutash, pa shtesa. Edhe sikur bateria e jashtme të pranohej si zgjidhje, mospërmbushet pjesa tjetër e Aneksit 1 (formati fizik 2–3U), sepse konfigurimi kalon në 4U kur ofrohen dy pajisje nga 2U secila (UPS + bateri e jashtme).*
Formati fizik	*Rack-mount 19inch, maksimum 2U–3U*	*UPS (2U) + modul shtesë baterie (2U) i nevojshëm për te arritur autonominë = 4U.*	*Kombinimi prej 2 pajisje (UPS 2U + Bateri 2UN) tejkalon maksimumin e Aneks 1 qe eshte kerkuar 2-3Unit . Oferta përmban faktikisht 6 kuti fizike në vend të 3 të kërkuara nga Aneksi 1.*

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Aneksi 1 kërkon një UPS Rack të vetëm, që brenda një trupi prej maksimum 2U–3U të japë vetë 5 minuta autonomi në 100% ngarkesë, me bateri të brendshme të zëvendësueshme.

Oferta e operatorit të rekomanduar nuk e arrin këtë kërkesë me njësinë bazë ***UPS OLS3000ERT2UA (2U)****, sepse, sipas broshurës dhe vetë prodhuesit, kjo njësi ka vetëm* ***4,2 minuta autonomi****. Prandaj, operatori i rekomanduar i shton një modul të dytë të jashtëm të baterive* ***(extend battery module) BPSE72V40ART2U****, po ashtu në format 2U.*

*Kjo zgjidhje e arrin autonominë duke bashkuar dy produkte (****UPS 2U + bateri e jashtme 2U****), por krijon një problem të dytë, të pavarur: trupi gjithsej bëhet* ***4U****, pra më i madh se maksimumi i lejuar prej* ***2–3U sipas Aneksit 1****. Kërkesa e Aneksit 1 është e qartë: autonomia dhe kufiri i hapësirës fizike duhet të përmbushen njëkohësisht, nga e njëjta zgjidhje (nga UPS-i). Të dyja problemet janë të lidhura (njëri e shkakton tjetrin), por secili përbën shkelje të Aneksit 1.*

Pretendimi 2 - UPS Tower (Vertical)
Mospërmbushje e autonomisë, bateri jo të zëvendësueshme, dhe shtim i produktit dytësor për plotësim te autonomisë.

Specifikimi teknik	***Kërkesa (Aneksi 1)***	***Zgjidhja e ofruar nga OE i rekomandaur***	***Pse nuk përmbushet specifikimi teknik nga modelet e ofruara***
Autonomia	*Minimum 5 minuta autonomi në ngarkesë të plotë.*	*Cyberpower OLS3000EA. Fleta teknike zyrtare e prodhuesit tregon vetëm 4,2 minuta autonomi për njësinë bazë.*	*Njësia vetë UPS nuk arrin 5 minuta, 5 minutat arrihen vetëm me shtimin e një moduli të jashtëm baterie (BPSE72V40A). Kjo bie në kundërshtim me kërkesën teknike të Aneksit 1, sepse specifikimi i autonomisë i referohet vetë njësisë UPS Tower, e jo një produkti dytësor shtesë (Extend Battery Module).*
Bateria	*Bateri të brendshme të zëvendësueshme.*	*Broshura e ofruar e modelit OLS3000EA tregon se baterite e UPS nuk zevendesohen* ***"User-replaceable: No"*** *dhe po ashtu referuar faqes zyretare për modulin shtesë te ofruar BPSE72V40A* ***"User-replaceable: No"*** *.*	*As njësia bazë, as moduli i jashtëm shtesë nuk kanë bateri të zëvendësueshme nga përdoruesi në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesën e Aneksit 1.*

Njësia bazë UPS Tower e ofruar, ***OLS3000EA****, nuk e arrin vetë minimumin prej* ***5 minutash autonomi në ngarkesë të plotë****, sepse, sipas të dhënave zyrtare aktuale të prodhuesit, ky model ka*

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

***vetëm 4,2 minuta**. Për ta plotësuar këtë kërkesë, operatori i rekomanduar shton një modul të jashtëm shtesë baterie, **BPSE72V40A (Extend Battery Module)**. Kërkesa e Aneksit 1 për autonomi i referohet vetë njësisë **UPS Tower** me bateritë e saj të brendshme, e jo një produkti të dytë, të jashtëm e opsional. Prandaj edhe ofrimi i dy produkteve në vend të një të vetmi nuk e shpëton mospërmbushjen.*

*Më tej, vetë prodhuesi deklaron zyrtarisht se bateria e brendshme e njësisë bazë (UPS-it) nuk është e zëvendësueshme nga përdoruesi (**"User-replaceable: No"**) pikërisht e kundërta e asaj që kërkon **Aneksi 1 ("Bateri të brendshme të zëvendësueshme")**. Sipas të dhënave zyrtare të prodhuesit, as moduli i jashtëm shtesë **BPSE72V40A** nuk ka bateri të zëvendësueshme nga përdoruesi (**po ashtu "User-replaceable: No"**). Pra, në konfigurimin e ofruar, asnjëra prej dy pajisjeve nuk e plotëson kërkesën e Aneksit 1 për bateri të zëvendësueshme, as njësia bazë, as moduli shtesë.*

Pretendimi 3 - Kabllo UTP Cat6
Përçuesi nuk është 100% bakër

Karakteristika	***Kërkohet (Aneksi 1)***	***Ofrohet***	***Pse nuk përmbushet***
Materiali i përçuesit	*100% Bakër (Copper).*	*Kabllo MicroConnect CAT6 U/UTP. Broshura zyrtare e prodhuesit e përshkruan si "constructed with copper-clad aluminum strands" (CCA).*	*Vetë prodhuesi deklaron se përçuesi është alumin i veshur me bakër (CCA), jo bakër i pastër, siç kërkohet shprehimisht nga Aneksi 1.*

Shpjegim:

*Aneksi 1 kërkon, pa mundësi ekuivalence, **100% Bakër (Copper).** Broshura zyrtare e vetë prodhuesit MicroConnect, për produktin konkret të ofruar, e përshkruan atë shprehimisht si **"CCA" (copper-clad aluminium)**, alumin i veshur me bakër, jo bakër i pastër. Kjo bie ndesh drejtpërdrejt me kërkesën e Aneks 1".*

Lidhur me pretendimet ankimore, është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe se komisioni vlerësues nuk e ka shfrytëzuar fare mundësinë për të kërkuar sqarime shtesë me qëllim që të vërtetohet nëse janë përmbushur kërkesat e DT. Gjatë sqarimeve shtesë nuk lejohet dorëzimi i dokumenteve të reja apo ndryshimi material i ofertës por vetëm ofrimi i sqarimeve mbi dokumentet e ofertës.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.10.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net